



Lidership

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Lidership Përmbajtja

Lidership;

|

- ▶ *Stilet e lidershipit*
- ▶ Teoria e Lidershipit e bazuar në situatë



Stilet e lidërsnipit;
Teoria e Lidërsnipit e
bazuar në situatë

Teoria e Lidershitit e bazuar në Situatë Përshkrimi

Teoria e rastit-Paparashikueshmerise.

Në një qasje më progresive ndaj lidershitit, teoria e Paparashikueshmerise, rekomandon përputhjen e stilit të prijësit me situatën e duhur, e cila përfshin përputhjen me ekip të njerëzve dhe qëllimet.

Dy teoritë e zakonshme të paparashikuara janë:

- Teoria shteg-qëllim dhe
- Teoria e bazuar në situatë



Teoria e Lidershitit e bazuar në Situatë Përshkrimi

Teoria e Lidershitit e bazuar në Situatë

rekomandon që, situata të ndryshme bëjnë thirrje për lloje të ndryshme të udhëheqjes.

Kjo kërkon që liderët të ndryshojnë stilin e tyre sipas aftësive të pasuesve të tyre.



Teoria e Lidërsipit e bazuar në Situatë Përshkrimi

Një prej qasjeve më të rëndësishme të lidërsipit është lidërsipi i bazuar në situatë (ang. Situational approach). Kjo qasje u dizajnuar nga Hersey dhe Blanchard 1969 në bazë të teorisë 3-D të Reddin për stilet e menaxhmentit.

Teoria e Lidershitit e bazuar në Situatë

Përshkrimi

Premisa bazë e kësaj qasjeje është se nevojitet lidershipi specifik për situata specifike. Nga ky këndvështrim lidershipi efektiv është ai lidership i cili adaptohet nevojës dhe kërkesave të situatës. Si i tillë ky lidership përbëhet prej dy dimensioneve:

- ❑ dhënien e urdhëresave dhe
- ❑ mbështetjen e vartësve.





Teoria e Lidershitit e bazuar në Situatë

Përshkrimi

Liderët efektiv janë ata lider të cilët janë në gjendje të kuptojnë se cilat janë nevojat e të punësuarve dhe si pasojë të adaptojnë stilin e tyre të lidershitit ndaj nevojave të vartësve.





Sjellja e bazuar në urdhëresa

- ▶ Formati I lidershit që bazohet në situatë mund të klasifikohet në katër kategori të posaçme të urdhëresave dhe dhënies së mbështetjes (shih diagramin e më sipërm).
- ▶ Formati i parë (S1) që bazohet në urdhëresa shumë të shprehura dhe mbështetje të dobët paraqet formatin urdhërues. Duke shfrytëzuar këtë qasje lideri ngrite komunikimin në realizimin e qëllimeve dhe shumë pak kohë shpenzon në mbështetje. Duke përdorur këtë stil lideri jep instruksione mbi qëllimet që vartësit duhet t'i realizojnë, në cilën mënyrë dhe monitoron punën e tyre.

Sjellja e bazuar në mentorim

- ▶ Formati i dytë (S2) njihet si mentorim në të cilën kemi *urdhëresa të fuqishme dhe mbështetje të fuqishme*. Në suaza të këtij formati lideri në të njëjtën kohë orientohet në komunikim të drejtuar në realizimin e qëllimeve por edhe në komunikim për realizimin e nevojave sociale dhe emocionale të vartësve. Formati i mentorimit nënkupton se lideri krijon lidhshmëri me vartësit duke i fuqizuar dhe duke kërkuar kontributin e tyre. *Mentorimi është vazhdimësi e stilit (S1)* duke marrë parasysh se nënkupton se lideri është ai që sjell vendimet përfundimtare sesi dhe në ç'mënyrë do të realizohen qëllimet.

Sjellja e bazuar në mbështetje

Formati i tretë (S3) përshkruan liderin i cili në pjesën më të madhe merret me mbështetje dhe shumë dobët shprehet sjellja e bazuar në dhënien e urdhëresave. Me aplikimin e këtij formati lideri nuk përqendrohet ekskluzivisht në qëllimet por shfrytëzon sjelljen e bazuar në mbështetje që të inkurajoj të punësuarit gjatë realizimit të detyrave të vinë në shprehje shkathtësitë e tyre.

Ky format nënkupton dëgjimin e të tjerëve, dhënien e shpërblimeve, kërkimin e inputit dhe dhënien e informatave kthyesë. Kur sjell vendimet e përditshme dhe operative lideri që shfrytëzon këtë format transferon kontrollin tek vartësit por përsëri është prezent në zgjedhjen e problemeve. Ky lider është shumë i hapur për dhënien e shpërblimeve dhe për mbështetje sociale për vartësit.

Sjellja e bazuar në delegim

- ▶ Formati (S4) është model ku nuk ka as mbështetje e as urdhëresa të shprehura. Ky format njihet si delegim. Gjatë shfrytëzimit të këtij formati lideri jep një numër të vogël të instruksioneve për detyrat dhe nuk kujdeset tepër për mbështetjen sociale pra nuk mundohet të inkurajoj vetëbesimin dhe motivimin e të punësuarve për realizimin e detyrave.
- ▶ *Lideri që shfrytëzon formatin (S4) lejon që vartësit të marrin kontrollin.*

Format e leadershipit

Format e leadershipit të bazuar në situatë ngërthejnë mënyrat e sjelljes së personit që mundohet të ndikoj tek të tjerët duke përfshirë sjelljen e bazuar në urdhëresa (shpërndarjen e detyrave) dhe sjelljen e bazuar në mbështetje (krijimin dhe fuqizimin e raporteve ndër-njerëzore).



Format e leadershipit

Sjellja e bazuar në urdhëresa u ndihmon anëtarëve që të realizohet qëllimi i organizatës duke lëshuar direktiva, duke definuar qëllime dhe metoda për evaluim, duke përcaktuar harqe kohore për realizimin e detyrave, duke definuar rolet dhe duke përcaktuar mënyrën sesi mund të realizohen qëllimet



Si përshkruhet lidershipi i bazuar në situatë

- ▶ Lidershipi i bazuar në situatë bazohet në premisën së të punësuarit lëvizin lartë e poshtë në nivelet hierarkike të zhvillimit dhe kjo trajektore paraqet shkallë relative të kompetencave dhe përkushtimit në punë.
- ▶ Që të kemi lidership efektiv është me rëndësi të përcaktohet niveli i zhvillimit të vartësve dhe më pas të adaptohet stili i lidershipit me nivelet e zhvillimit të tyre.



Si përshkruhet lidërsशिpi i bazuar në situatë

Aktiviteti i parë i liderit është të përcaktoj gjendjen faktike.

Ai/ajo duhet tu përgjigjet pyetjeve që vijojnë:

- ▶ Cilët janë detyrat të cilat duhet të kryhen nga vartësit?
- ▶ A janë këto detyra komplekse?
- ▶ A kanë vartësit shkathtësitë e duhura për realizimin e detyrave?
- ▶ A kanë vullnet të përfundojnë punën që kanë filluar?



Lidershipi i bazuar në situatë - Rezyme

Lidershipi i bazuar në situatë ofron rekomandime për lidershipin me të cilat sugjerohet sesi liderët mund të jenë efektiv në kontekste të ndryshme organizative në suaza të detyrave të ndryshme.

Kjo qasje ofron një model ku sugjerohet liderëve sesi të sillen në pajtim me nevojat në situata specifike.



Lidershipi i bazuar në situatë - Rezyme

Ekzistojnë katër anë të fuqishme të lidershipit të bazuar në situatë.

- ▶ Së pari, shumë dijetarë pretendojnë këtë model si qasje standarde për trajnimin e liderëve,
- ▶ Së dyti paraqet qasje praktike që lehtë mësohet dhe lehtë mund të aplikohet,
- ▶ Së treti në këtë qasje jepen rekomandime të qarte sesi lideri duhet të veprojnë nëse dëshirojnë të përmirësojnë efektivitetin e tij,
- ▶ Së katërti në lidershipin e bazuar në situatë pranohet dhe potencohet se nuk ekziston formati më i mirë i lidershipit dhe se liderët duhet të jenë fleksibil dhe të adaptojnë formatin e tyre ndaj nevojës në situatën gjegjëse.





Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com